



Prishtinë, 23 dhjetor 2014
Kodi i ZRRE-së: V_670_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1.6 nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 paragrafi 4 nënparagrafi 4.1 dhe Nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 2, paragrafit 3, nënparagrafit 3.1 dhe 3.3, Nenit 18 paragrafi 3, Nenit 38 dhe Nenit 38 dhe nenin 39 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Vendimi V-619-2014 për aprovimin e Udhëzimi për shthurje të KEDS/ Operatori i sistemit të Shpërndarjes nga KEDS/ Furnizuesi Publik, të datës 29 prill 2014;
- Dispozitat e Nenit 16 paragrafi 2 të Licencës për Furnizuesin Publik me Energji Elektrike dhënë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – SH.A. (KEDS) – Divizioni i Furnizimit, me numër të regjistrimit ZRRE/Li_07/12 të datës 18.07.2012;
- Kërkesën për Shthurje Ligjore të KEDS-it, të datës 24.03.2014;
- Kërkesën për transferim të licencës dhe asetëve, të KEDS, të datës 07.10.2014; dhe
- Aplikacionin për transferim të Licencës për Furnizim Publik, të bërë nga “KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY” J.S.C. (KESCO), të datës 28.10.2014,

në seancën e mbajtur me datë 23 dhjetor 2014, nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** transferimi i Licencës së Furnizuesit Publik me Energji Elektrike nga Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – SH.A. (KEDS) – Divizioni i Furnizimit, me numër të regjistrimit ZRRE/Li_07/12 në “KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY” J.S.C. (KESCO).
- II. APROVOHET** transferimi i asetëve nga “KEDS” SH. A. në “KESCO” J.S.C. të bashkangjitura me shkresën e datës 18 dhjetor 2014 të “KEDS” SH.A.
- III.** Transferimi i licencës dhe asetëve nga pika I. dhe II. të dispozitivit të këtij Vendimi do të hyjë në fuqi nga data **01 janar 2015**.

A r s y e t i m



- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 07.10.2014 nga shoqëria KEDS SH. A., ka pranuar Kërkesën për transferim të licencës për furnizim publik me energji elektrike si dhe transferim të aseteve nga “KEDS” SH. A. në “KESCO” J.S.C.
 - “KEDS” SH. A., në kërkesën e saj, ka sqaruar se në pajtim me vendimit Nr. V – 619-2014 për shthurje të KEDS/ Operatori i sistemit të Shpërndarjes nga KEDS/ Furnizuesi Publik, ka filluar procedurat për shthurjen e Divizionit të Shpërndarjes nga Divizioni i Furnizimit, të cilat do të përfundohen deri më 01 janar 2015. “KEDS” SH.A. ka sqaruar se procesi i shthurjes ligjore do të përfshij transferimin e aseteve dhe detyrimeve ekzistuese, të operuara nga “KEDS” Furnizuesi Publik në kompaninë e re për furnizim gjegjësisht në “KESCO” J.S.C.
 - Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 28.10.2014, nga shoqëria “KESCO” J.S.C. ka pranuar kërkesën për transferim të licencës për furnizim publik të energjisë elektrike nga “KEDS” SH. A., Divizioni i Furnizimit në “KESCO” J.S.C., si dhe aplikacionin për Licencë të Furnizimit Publik me energji elektrike me të gjitha dëshmitë e kërkuara me aplikacion të shoqërisë “KESCO” J.S.C .
 - Kërkesa e “KEDS” SH. A. për transferim të Licencës së Furnizuesit Publik me Energji Elektrike të datës 04 tetor 2006, me numër regjistrimi ZRRE_Li_07/06 (modifikuar nga ZRRE me datë 18.07.2012, me numër regjistrimi ZRRE/Li_07/12) nga “KEDS” SH. A. në “KESCO” J.S.C, si dhe kërkesa për transferim të aseteve nga “KEDS” SH. A. – Divizioni i Furnizimit në Kompaninë e re të furnizimit “KESCO” J.S.C është bërë në pajtim me Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
 - ZRRE ka vlerësuar kërkesat e cekura më lartë si dhe dëshmitë dhe të gjitha dokumentet tjera të bashkangjitura aplikacionit për Licencë të furnizimit me energji elektrike, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- IV.** Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës dhe përmbajtja e licencës mbeten të njëjta, në pajtim me Nenin 38 paragrafin 4 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
- V.** Nga momenti i transferim të kësaj Licence, obligohet i licencuari që ta njoftoj ZRRE-në për çdo ndryshim eventual të kushteve apo dëshmime të dërguara me aplikacion si dhe Marrëveshjeve që do të nënshkruhen mes “KEDS” SH.A dhe “KESCO” J.S.C.
- VI.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VII.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

